



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK**

Nr 143 Prot.

Gjirokastër, më 27/01/2020

THIRRJE

**Mbi ngritjen e Komisionit të Hartimit të Rregullores së Zgjedhjeve për Autoritete dhe Organe
Drejtuese të Universitetit "Eqrem Çabej" (2020 – 2024)**

Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 102, pika 4, ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 131, si dhe Urdhërit të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, **nr. 8 datë 14. 01. 2020** "Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë", Senati akademik i Universitetit "Eqrem Çabej" në mbledhjen e tij të **datës 27. 01. 2020** diskutoi për ngritjen e komisionit për hartimin e rregullores së zgjedhjeve për autoritete dhe organe drejtuese të Universitetit "Eqrem Çabej" (2020 – 2024).

Senati Akademik vendosi që komisioni të përbëhet prej pesë anëtarësh me këtë përbërje:

- a. Juristi i institucionit
 - b. Tre përfaqësues të personelit akademik, nga një për secilën njësi kryesore (FESHSH, FSHN, FE).
 - c. Një përfaqësues i studentëve.
1. Përfaqësuesit e personelit akademik dhe përfaqësuesi studentor vetëkandidojnë.
 2. Përfaqësuesit e personelit akademik nuk duhet të jenë autoritete të zgjedhura, si dhe kandidatë për autoritete dhe organe drejtuese në zgjedhjet e institucionit, **8 maj 2020**.
 3. Përfaqësuesi studentor duhet të jetë student me kohë të plotë dhe të mos jetë kandidat për anëtar të senatit akademik.
 4. Aplikimi bëhet pranë sekretarisë së sanatit akademik në datat **27 dhe 28 janar 2020, deri në orën 16.00**.



5. Dokumentacioni për aplikim:

- a. fotokopje e kartës së indentitetit,
 - b. për përfaqësuesin e personelit akademik dokumenti që vërteton punësimin me kohë të plotë.
 - c. për përfaqësuesin studentor dokumenti që vërteton statusin e studentit me kohë të plotë.
 - d. Deklarata për moskandidim për autoritete dhe organe drejtuese në zgjedhjet e 8 maj 2020.
6. Kandidaturat votohen në Senatin Akademik në datën **29 janar 2020, ora 11.00.**

SENATI AKADEMIK
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"

